

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-068/13

Prishtinë, 21 tetor 2013

Në çështjen juridike të:

M/S

Pala ankuese/Paraqitësi i kërkesës

e përfaqësuar nga

Z.S, avokate në N...,

kundër

K.K.P

Pala përgjegjëse/Pala përgjegjëse në kërkesë

Kolegji i Apelit të AKP-së të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Supreme) i përbërë nga Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit të EULEX-it, Willem Brouwer dhe Sylejman Nuredini, gjyqtarë, në ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/126/2012 (lënda është regjistruar në AKP me numrin 14275), të datës 6 qershor 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 17 tetor 2013, mori këtë

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e M.S;
2. Konfirmohet vendimi i KKPK-së nr. KPCC/D/A/156/2012 i datës 6 qershor 2012, për sa i përket kërkesës nr. KPA14275;
3. Obligohet M.S që t'i paguajë shpenzimet e procedurës në shumë prej 60 euro (gjashtëdhjetë euro) brenda 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

1. Çështjet procedurale

- 1.1. Më 3 tetor 2006, M.S ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku ka kërkuar konfirmimin e së drejtës së saj pronësore ndaj gjysmës së ngastrës 11/22 ha 9 ari e 20 m² në zonën kadastrale të Podujevës, e regjistruar në fletën poseduese 348 (këtej e tutje: prona).
- 1.2. Me vendimin e datës 6 qershor 2012, KKPK-ja e ka gjetur kërkesën si të papranueshme për mungesë juridiksioni. Vendimi është pranuar nga M.S më 30 janar 2013.
- 1.3. M.S ka paraqitur ankesë në AKP kundër vendimit të KKPK-së më 27 shkurt 2013.
- 1.4. Një kopje e ankesë i është dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë, e cila nuk ka paraqitur ndonjë përgjigje në ankesë.

2. Çështjet faktike

Kolegji i Apelit i merr si fakte çështjet e mëposhtme, të cilat janë vërtetuar nga KKPK-ja dhe nuk janë kundërshtuar nga palët ose përndryshe nuk janë dëshmuar si të gabueshme:

- 2.1. M.S kishte qenë pronare legjitime e pronës së paku deri më 8 shtator 1999.
- 2.2. Prona ishte ekspropriuar nga këshilli komunal i Podujevës ma anë të aktit të datës 8 shtator 1999 me qëllim të shfrytëzimit si bazë e ndërtesës.
- 2.3. M.S nuk ka pranuar ndonjë kompensim për humbje të pronës.

3. Kontesti ligjor:

3.1 Pyetjes që duhet t'i jepet përgjigje nga Gjykata Supreme është nëse KKPK-ja më të drejtë e ka konsideruar ankesën e M.S si të papranueshme.

4. Arsyetim ligjor:

Juridiksioni

4.1 Gjykata Supreme ka juridiksion që të vendos lidhur me kontestin e lartpërmendur ligjor.

Pranueshmëria

4.2 Me vendimin e datës 6 qershor 2012, KKPK-ja e ka gjetur si të papranueshme kërkesën për shkak të mungesës së juridiksionit. Vendimi është pranuar nga M.S më 30 janar 2013. Ajo ka paraqitur anekse në AKP kundër vendimit të KKPK-së më 27 shkurt 2013, që është brenda afatit prej 30 ditësh të cekur në nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 për zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale.

Prandaj, ankesa e M.S është e pranueshme.

Meritat

4.3. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhër nga Komisioni për kthim në posedim të pronës nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon jo vetëm pronësinë e pronës së paluajtshme private, por edhe që ai tani nuk është në gjendje që t'i ushtrojë këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

4.4. Pronësia legjitime nuk është kontestuar nga pala përgjegjëse në ankesë dhe, mbase vetëm për hir të kompletimit, duhej të konfirmohej nga KKPK-ja. Kështu që, M.S duhet të dëshmojë se ajo tani nuk është në gjendje që t'i ushtrojë këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

4.5. Në ankesën e saj ajo ka deklaruar se nuk ka qenë në gjendje që t'i ushtrojë të drejtat e saj pronësore në kohën kur e kishte paraqitur kërkesën në AKP. Kjo kërkesë ishte regjistruar me 3 tetor 2006. Më shumë se 5 vite pas eksproprijimit në vitin 1999.

4.6. Vetë eksproprijimi ka ndodhur më 8 shtator 1999, pra pas periudhës së mandatit të cekur në nenin 3.1 të Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50 Kjo nënkupton se pamundësia për të ushtruar të drejtat pronësore duhet të ketë ndodhur në periudhën para asaj date.

4.7. As nuk janë përmendur fakte e as nuk janë paraqitur prova nga M.S me qëllim që një situatë e tillë të bëhej e besueshme. Në fakt, akti i eksproprijimit jep një udhëzimi juridik, ku ceket: *"Pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë kundër këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga marrja e këtij vendimi"*. Kjo do të thotë se në njëfarë mënyrë të drejtat pronësore kanë mundur të ushtroheshin në atë kohë.

1.4 Kjo bën Gjykatën Supreme që të arrijnë në përfundim se kërkesa e M.S nuk është objekt i mandatit të KKPK-së dhe për këtë arsye edhe është e papranueshme. Prandaj, hedhet poshtë ankesa e M.S dhe konfirmohet vendimi i KKPK-së.

1.5 Ky vendimi nuk ka ndonjë paragjykim në deklarimin e M.S se eksproprijimi ishte i paligjshëm dhe/apo asaj duhet t'i paguhet kompensimi për këtë eksproprijim..

4. **Shpenzimet e procedurës**

4.1 Në përputhje me nenin 8.4 të Urdhresës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit.

4.2. Si pasojë, zbatohet regjimi normal i pagesës së taksave gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

4.3. Kështu që, taksat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €
- Taksa për nxjerrjen e aktgjykimit (10.21, 10.15 dhe 10.1): 30 €;

Këto taksa gjyqësore duhet të merren përsipër M.S e cila e humbi rastin.

4.4. Sipas nenit 45.1 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, afati për pagesën e këtyre taksave është 90 (pesëmbëdhjetë) ditë. Neni 47 paragrafi 3 parashihet që në rast se pala nuk paguan taksën brenda afatit, pala do të duhet të paguaj një gjobë prej 50% të shumës së taksës. Nëse pala nuk e paguan taksën në afatin e dhënë, atëherë bëhet ekzekutimi i detyrueshëm i pagesës.

5. Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova , Kryetare e Kolegjit, EULEX

Willem Brouwer, Gjyqtar i EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX-it